



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 04.12.2020)

Pika 5 e rendit të ditës me objekt: Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Administrative të Apelit, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:10 dhe mbaroi në orën 12:05.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami*** (kryetare)
- 2. Medi Bici*** (anëtar)
- 3. Fatmira Luli*** (anëtare)
- 4. Brunilda Kadi*** (anëtare)
- 5. Ilir Toska*** (anëtar)
- 6. Alban Toro*** (anëtar)
- 7. Brikena Ukperaj*** (anëtar)
- 8. Erjon Muharremaj*** (anëtar)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje anëtarët e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Marçela Shehu, z. Maksim Qoku dhe z. Dritan Hallunaj.***

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Vildan Kaloshi, Drejtor pranë Drejtorisë së Shërbimeve Juridike.*
2. *Ermira Lleshi, Specialiste pranë Sektorit të Oponencës Juridike & Përafrimit të Legjislacionit.*
3. *Pjesë nga stafi administrative i KLGJ-së.*

RENDI I DITËS:

5. Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën e Administrative të Apelit, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.¹

Objekt i kësaj mbledhjeje urgjente e Këshillit të Lartë Gjyqësor është trajtimi i çështjes “Caktimi i gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në Gjykatën Administrative të Apelit”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Relator i kësaj çështjeje të rendit të ditës është zoti Ilir Toska.

Shkurtimisht parashtrohet se Gjykata Administrative e Apelit ka paraqitur një kërkesë për një nevojë urgjente të saj, për përjashtim gjyqtari.

Trajtohet relacioni për caktim gjyqtari në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ndër të tjera, në relacion thuhet që, **Gjykata Administrative e Apelit** ka paraqitur nevojë për 1 çështje gjyqësore.

Për nevojat si më lart të Gjykatës Administrative të Apelit, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Propozimet e Komisionit janë:

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Gjykata nga duhet të përzgjidhet, me short, gjyqtari që do të caktohet për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë dhe numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 çështjeje gjyqësore të veçantë, të jetë 1.

Gjithashtu Komisioni i Zhvillimit të Karrierës propozon:

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti Kryetari në detyrë (Zëvendëskryetari) i Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: Z. Ridvan Hado.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, për të cilën nuk ka njoftim nga gjykata për kthimin në detyrë pas përfundimit të lejes afatgjatë të akorduar nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë dhe refuzimit të zgjatjes së lejes nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konkretisht: Znj. Evjeni Sinojmeri.

Në shortimin e çështjes të përjashtohet nga shorti gjyqtarja e Gjykatës së Apelit Tiranë, e cila nuk është në detyrë për arsye shëndetësore, konkretisht: Znj. Maria Qirjazi.

Në shortimin e çështjes të përjashtohen nga shorti gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Tiranë, të cilët ditën e sotme kanë gjykime të çështjeve urgjente (masa sigurimi) , konkretisht: Znj. Valdete Hoxha, Z. Genti Shala Z. Shkëlqim Mustafa.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhet (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, gjyqtarja Elbana Lluri.

Me kaq mbyllet procedura e shortit dhe kjo çështje e rendit të ditës, ashtu si edhe mbledhje planerë.

* * *

(Pika 5 e rendit të ditës)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor